



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Mars 2018

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr. Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)
- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com

Procesi i regjistrimeve kontabel

- Në procesin e tij, kontabiliteti është i fokusuar në sigurimin dhe regjistrimin e transaksioneve të cilat kanë ndikime ekonomike në firmë.
- Instrumenti kryesor i procesit kontabel është llogaria.
- Llogaria (konto) është një format standard, i cili përdoret për grumbullimin e efekteve monetare të transaksioneve për çdo element të PF.
- Ditari si njësi tjetër bazike, përdoret për regjistrimin e transaksioneve në mënyrë kronologjike sipas datave të ndodhjes së tyre
- Libri kryesor (I madh) është një regjister në të cilin përfshihen në të gjitha llogaritë

Sistemi i regjistrimit të dyfishtë

- Në kontabilitet regjistrimi i transaksioneve bazohet në sistemin e dyfishtë.
- Regjistrimi i dyfishtë nënkupton se efektet e cdo transaksioni evidencohen së paku në dy llogari sepse cdo ndërrim ekonomik ka dy efekte të dyanshme.
- Llogaria e formes T përbëhet prej tri elementeve:
 - a) Titulli i llogarisë
 - b) Anës së majtë (Debi)
 - c) Anës së djathtë (Kredi)
- Barazimi i totalit të debisë dhe kredisë në regj. e cdo transaksioni paraqet bazën e kont. të dyfishtë

Zgjerimi i ekuacionit të bilancit

- Ekuacioni bazik i kontabilitetit në formë të zgjeruar i cili involvon të hyrat, shpenzimet dhe dividenden.
- Pasuria
- = Kapitali aksionar
- + Fitimi i mbajtur
- + Detyrimet
- + Të hyrat
- - Shpenzimet
- - Dividendi

Shembuj të zgjidhur

- Analizë dhe evidencim të transaksioneve në llogaritë e librit kryesore
- Faqe 99 – 103

Regjistrimi i transaksioneve në ditar

- Në sistemin e kontabilitetit të praktikë, informacionet lidhur me transaksionin afarist, së pari regjistrohen në ditar.
- Edhe pse në aspektin teknik është i mundur të bëhet drejtpërdrejt regjistri në llogarinë e librit kryesor, megjithatë të gjitha transaksionet fillimisht regjistrohen në ditar për disa arsye:
 - a) Në radhë të parë ditari ofron informacion komplet nga një burim lidhur më një transaksion,
 - b) Përdorimi i ditarit në regjistrimin e transaksioneve mundëson eliminimin e gabimeve lidhur me evidencen e shumave në debi dhe kredi.

Regjistrimi i transaksioneve ne ditar

- Firmat në praktikë përdorin forma të ndryshme të ditarëve. Dy lloje kryesore të ditarëve janë:
- Ditari i përgjithshem
- Ditari i vecantë

- Diagrami apo tabela e ditarit përmban të dhenat për transaksionet e sistemuara në kolona si: datën, muajin, vitin, emrin e llogarise dhe përshkrimin, referencën e llogarise dhe kolonen debi - kredi

Forma e ditarit

DITARI				
Data	Emri I llogarisë dhe përshkrimi	Ref.	Debi	Kredi

Libri kryesor

- Pas regjistrimit të transaksioneve në ditar, hapi tjetër, në procesin kontabël konsiston me bartjen e tyre në llogarinë e librit kryesor. Fizikisht pothuajse llogaritë mbahen në librin kryesor.


Bilanci vertetues

- Bilanci vërtetues është një mjet ndihmës i cili përdoret në përgatitjen e bilancit. Ai praktikisht përfshin saldot e të gjitha llogarive të librit kryesor, për të dëshmuar se shuma e llogarive me saldo debitore është e barabartë me shumën e llogarive me saldo kreditore.
- Në qoftë se shuma e përgjithshme në të dy kolonat është e barabartë kjo dëshmi tregon se nuk ka pasur gabime dhe e kundërta

Bilanci vertetues

- Bilanci provues mund të ndertohet cdo kohë, por zakonisht firmat e bëjnë në fund të periudhës kontabël.
- Në startin e fazes së dytë, të ciklit kontabël, është ndërtimi i bilancit vërtetues pa veprimet rregulluese.
- Pra fillimisht marrim saldot përfundimtare të të gjitha llogarive në librin kryesor.

Cikli kontabel (procesi kontabel)



Shembull

- Problemi 3.1. – Faqe 122
- Problemi 3.2. – Faqe 123

Bilanci vertetues i korigjuar

- Bilanci vërtetues i rregulluar në fakt është një listë e saldove të llogarive të librit kryesor pas bartjes së regjistrimeve rregulluese.
- Në ciklin kontabel përgatitja e bilancit vërtetues të rregulluar bëhet pas vendosjes së regjistrimeve rregulluese në ditar dhe bartjes së tyre në librin kryesor
- Përgaditja e pasqyrave financiare mund të bëhet drejtpërdrejt nga bilanci vërtetues i rregulluar

Përgatitja e pasqyra financiare

- Pasqyrat financiare janë të ndërlidhura ndërmjet vete dhe se përgatitja e tyre duhet të bëhet në këtë renditje si në vijim
 - 1) Pasqyra e të ardhurave
 - 2) Pasqyra e kapitalit të pronarit
 - 3) Bilanci i gjendjes

Pyetje



Suksese!